

Çfarë janë të dhënat personale?

Të gjitha informacionet që mund të identifikojnë personalitetin tuaj paraqesin të dhëna personale. Emri, mbiemri, fotografia nga e cila ti mund të identifikohesh, datëlindja, adresa, profesioni, numri i telefonit, IP adresa e kompjuterit, janë të gjitha të dhëna personale.

Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale

Mbrojtja e të dhënave personale është e drejtë fundamentale e garantuar me Kushtetutë neni 36 dhe e rregulluar edhe me Ligjin 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ky ligj ka për qëllim që ti të jesh i sigurt se të dhënat tuaja personale shfrytëzohen në mënyrë të drejtë dhe nuk keqpërdoren. Njëherit, mbrojtja e të drejtës në privatësi është e garantuar me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Mbrojtja e të dhënave personale është pjesë e së drejtës në privatësi, si një nga të drejtat dhe liritë elementare të njeriut.

Për më shumë informata lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale ju mund të kontaktoni Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Republikës së Kosovës në email adresën amdp@rks-gov.net.

Ju mund të gjeni material dhe këshilla për shfrytëzim të sigurt të internetit edhe në www.amdp-rks.org dhe në www.internetisigurte.org.

Mbrojtja e të dhënave personale të fëmijëve



www.internetisigurte.org



Qendra për studime të avancuara
Center for advanced studies




"Ky projekt u financua përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit."



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

www.amdp-rks.org



Përdorimi i të dhënave personale

Të dhënat tuaja personale nuk mund të shfrytëzohen nga të tjerët pa pëlqimin tuaj. Ti mund të japësh pëlqimin tënd në mënyrë vullnetare dhe këtë pëlqim ke të drejtë ta tërheqësh në çdo kohë. Është e drejtë e juaja të kërkonit nga miqtë tuaj që mos të postojnë informata ose foto tuajat në blogjet dhe faqet e rrjeteve sociale pa lejen tuaj.

Ti ke të drejtë të jesh i informuar se çfarë të dhënash personale ruajnë të tjerët për ty, për çka do t'i shfrytëzojnë dhe në çfarë mënyre kanë ardhur deri te të dhënat tua personale. Ti ke të drejtë të kërkohësh që të dhënat tua që nuk janë të sakta dhe të kompletuara të korrighohen.

Nëpërmjet motorëve të kërkimit (p.sh. Google, Yahoo) kërkonit emrin tuaj për tekst dhe foto. Nëse në një faqe interneti gjeni informata të ndjeshme për veten tuaj, drejtohuni kësaj faqe me një kërkesë për të hequr informacionet tuaja nga kjo faqe.

Për të dhënat personale të ndjeshme (të dhënat që zbulojnë origjinën etnike ose racore, përkatësinë fetare, jetën seksuale, shëndetin, veprimet penale) çdoherë duhet të kërkohet pëlqimi me shkrim.

Derisa ne nuk do të jepim informacionet tona personale për të huajt në rrugë, pse ta bëjmë atë online?

Rregulli dhe përgjegjësia

Është me rëndësi që të jesh i informuar për përgjegjësinë tënde kur dëshiron të ndash diçka me pjesën tjetër të botës. Për çdo gjë që ju publikoni në internet, mbani përgjegjësi të plotë. Rekomandohet që të lexoni së pari politikat e privatësisë për faqet e internetit në të cilat dëshironi të publikoni të dhëna personale.

Kur publikoni informata personale për veten tuaj apo për të tjerët, mbeten gjurmë elektronike në internet, siç janë IP adresa dhe evidenca e përdoruesit, të cilat janë informata të mjaftueshme për të zbuluar identitetin e secilit që bënë publikimin e atyre të dhënave. Prandaj para se të publikoni gjithmonë duhet të kërkonit pëlqimin paraprakisht.

Në vende publike shpesh janë të vendosura kamera për incizime. Megjithatë në ato zona duhet të ketë njoftim të çartë se ajo hapësirë është nën vëzhgimin e kamerave. Njëherit është i ndaluar edhe tregimi i inçizimit palës së tretë pa pëlqimin e personave të inçizuar, përveç policisë.

Publikimi i videove dhe i muzikës pa përdorimin e të drejtës për publikim është i paligjshëm. Mbrojtja e të drejtave të autorësisë është e garantuar me ligj.

Si të kërkojmë fshirjen e të dhënave personale

Ju mund të kërkonit fshirjen e të dhënave të cilat janë të publikuara pa lejen tuaj gjithmonë. Kjo mund të bëhet në këtë mënyrë:

- Duke kontaktuar personin i cili ka bërë publikimin e të dhënave personale nga i cili kërkonit që të bëjë fshirjen e tyre;
- Ju mund të kërkonit nga ofruesi i shërbimit të internetit (anglisht internet provider) që të bëjë fshirjen e të dhënave tuaja personale;
- Njoftoni prindin ose kujdestarin tuaj;
- Kontaktoni Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Republikës së Kosovës.



Këshilla për mbrojtje më të mirë

- Lexoni me kujdes politikat e privatësisë për faqet e internetit të cilat i përdorni;
- Publikoni sa më pak detaje që ju identifikojnë juve apo vendndodhjen tuaj;
- Kujdes, mos publikoni online gjëra të cilat nuk dëshironi të jenë publike;
- Mos ndani e-mail adresën private me njerëz që nuk i njihni dhe mbani vetëm për vete fjalëkalimin;
- Gjatë regjistrimit apo plotësimit të formularëve të ndryshëm, jepni vetëm informatat e kërkuara që janë të shënuara me shenjën e yllit (*);
- Vërtetoni se një faqe interneti është e sigurt duke kërkuar shenjat identifikuese